

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

SHFRYTEZIM I MINERALIT GUR GELQEROR

**ZONA MINERARE KONKURUESE NR 349/4, (ISH LEJA MINERARE NR 985),
OBJEKTI SHESI I AZINESË, SELENICË, QARKU VLORË**

**Njoftim Fituesi nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise Nr.498/2Prot,
dt.02.08.2023**

Dhjetor 2023



PERMBAJTIA

A) Një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit;	
B) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;	3
C) Një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër.	5
Ç) Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;	7
D) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;	8
Dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;	8
E) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përfaqësuara për rehabilitimin;	8
Ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;	11
Lloji i ndikimit	12
F) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).	13



A) Një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit;

Objekti i gurit gëlqeror, Sheshi i Azinesë, bën pjesë në Bashkinë Selenicë, Qarku Vlore. Rruga automobilistike nga degezimi i saj deri ne objekt pergjithesisht eshte ne gjendje jo te mire. Zona per rreth objektit eshte terren kodrinor i demtuar nga reshjet atmosferike te cilat kane krijuar lugina dhe perrenje te vegjel e cilet ne periudhen e ngrohte jane te thate, ndersa ne dimer marrin pamjen e rrekeve me pak uji. Ne zone zoterojne lartesi 698 m dhe 741 m ne jug te objektit, 751 dhe 738 m ne veri, 675 m ne lindje. Ne perendim relievi eshte ne renie.

Siperfaqia ne te cilen jane projektuar punimet e shfrytezimit eshte e prekur nga punimet minerare te meparshme. Gjate hartimit te projektit per vitet ne vazhdim grupi projektues ka marre ne konsiderate qe mos te preken siperfaqe shtese.

Brenda zones minerare bimesia nuk eshte e zhvilluar pasi ndodhet ne nje reliev shkembor dhe pa uje. Siperfaqja e zones minerale eshte e mbuluar nga bimesi si shkure, dellinja, gjemba etj te cilat nuk i kalojne 1.5-2 metra lartesi. Theksojme se ne kete zone jane zhvilluar punime shfrytezimi edhe me pare ku eshte i hapur nje horizont shfrytezimi, transhe kapitale, ka shesh depozitimi. Punimet e projektuara do te zhvillohen ne ne te njejten siperfaqe ku jane zhvilluar me pare punimet minerare.

Si rezultat i vepërimtarisë minerare të mëparshme, ne ato pjesë të sipërfaqes ku është punuar dhe ku do te vazhdojë të zhvillohet aktiviteti nuk ka mbulesë bimore.

Per kthimin e sipërfaqes në kushtet e mëparshme, për të krijuar sipërfaqe me mbulesë bimre, shoqeria ka hartuar dhe do të zbatojë progresivisht me shfrytëzimin planin e rehabilitimit, sipas kushteve të përcaktuara në Udhezimin e te dy ministreve, (MTM dhe MIE).

B) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Nga studimet hidrogeologjike dhe kqyrja e zonës ku janë zhvilluar punimet e shfrytëzimit dhe ku riplanifikohet rreth saj, nuk ka burime sipërfaqësore apo nëntokësore ujrash, të cilat mund të bëhen pengesë për punën në karierë ose të dëmtohen nga proceset e punës në karierë, të zhduken ose të ndotën duke krijuar shqëtësime për komunitetin në zonën për rreth zonës që shfrytëzohet. Pjerrësia e shpatit të zonës me kënd pjerrësie deri 25°, favorizon rrjedhjet e përkohshme me karakter vërshimi nga rreshjet e rrembyera.

Ujrat sipërfaqësore të krijuara nga rreshjet grumbullohen në shtratin e ultësirës në formë përroi, ku niveli hidrostatik i ujrave është afërsisht deri 2 m afër sipërfaqes së tokës.





Foto nga zona ku ndodhet objekti



Foto nga objekti



Kushtet hidrogeologjike dhe rrjeti hidrografiki rajonit.

Sic eshte permbendur edhe ne kapitullin 3.2 rajoni eshte i pasur me ujrata nentokësore dhe sipërfaqësore. Ato kane problematikat e tyre natyrore dhe fenomenve e tjera.

Ne zonen e objektit takohen shkëmbinj me porozitet çarje karstike me ujëpërcjellshmëri që ndryshon në kufij shumë të gjerë, vende-vende me vlera shumë të larta të saj, lidhen me shkëmbinj të karbonatike të Jurasikut, Kretakut, Paleocenit dhe Eocenit. Në këto shkëmbinj fenomeni i karstit është shumë i zhvilluar, e për rrjedhojë ata mbajnë resurse ujore të mëdha. Në zonat karstike koeficienti mesatar i infiltrimit të dobishëm shkon deri në 0.6-0.7. Sasitë më të mëdha të resurseve ujore nëntokësore drenojnë kryesisht në kuota të ulta me burime sipërfaqësore.

Per zhvillimin e projektit ne fjale jemi ne kushte te mira dhe nuk do te kemi ndikime ne ujrata sipërfaqësore apo nëntokësore.

Kushtet hidrografike dhe hidrogeologjike te vendburimit

Brënda kontureve të vendburimit s'ka burime uji dhe nuk parashikohet shfaqja e tyre gjate kryerjes së punimeve të shfrytëzimit. Objekti ben pjese ne nenzonen Jugperendimore te zones klimatike mesdhetare kodrinore. Sasia mesatare e reshjeve vjetore ka vlerën 1802 mm. Numri i ditëve me reshje më të mëdha se 0.1 mm lëkundet ndërmjet 87 dhe 103 ditëve. Në përgjithësi reshjet maksimale në këtë zonë rrallë herë bien në formë rrebeshi. Shtresa maksimale e borës arin vlerën 10-20 cm dhe shumë rrallë 25-35 cm, dhe këto të paqëndrueshme.

Ne aspektin hidrologjik mbi kuoten 160m per te cilen eshte bere llogaritja e rezervave probleme te ujembahtjes nuk ka, ujrata e çarjeve gjate kohes se reshjeve drenojne poshte ne kuota shume te ulta duke shkarkuar ne perroin e Sheshi i Azinesës.

C) Një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër.

Veprimtaria e nxjerrjes së gurit gëlqeror me karrirë, përpunimi i tij me impjant thyerje fraksionim, është veprimtari me ndikime të mundshme negative në mjedis. Shoqëria do të punojë për zhvillimin e projektit duke marrë masa dhe duke reduktuar në maksimum ndikimet negative në mjedis.

Ajo do kontrollojë dhe do të monitorojë vazhdimisht këtë veprimtari për të parandaluar ndotje dhe ndikime të pa ripaqrueshme.

Nga veshtrimi i projektit te propozuar dhe pervoja shume vjeçare e objeteve analogë rezultojnë se ndikimet e mundshme negative janë të kontrollueshme dhe të riparueshme, konkretisht:

1- Shqetesim i faunes ne zone

Sipërfaqja ku do te vazhdojnë të kryhen punimet e shfrytëzimit, ka qenë nën ndikimin e veprimtarisë minerare, ajo eshte e varfer nga bimësia, e cila pothuajse mungën plotësisht, rrjedhimisht proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Fakti qe ne zone ka



zhvillohen shume aktivitete te ngjashme, na jep te drejte te themi se nuk do te kemi ndonje shtim apo demtim habitati e ekosistemesh te virgjera. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit, do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle sidomos do te mbajne larg zones disa lloje shtazore.

2- Ndikime ne pejsazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti

Ndikimet më të mundshme janë në peisazhin e sipërfaqes së lejes minerare si dhe në relievin e saj, si rezultat i marrjes së mineralit, depozitimit të mbulesës dhe gëlqerorit.

Nder ndikimet me evidente do te jene ndryshime në pjerresise se terrenit dhe ato vizuale te pjesës se prekur.

Relivi do të marrë formën e karrierës me shkallë dhe shesh të depozitimi të gurit gëlqeror dhe mbulesës.

3- Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer

a- Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet. Sasia e gazeve NO₂ dhe SO₂ qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara.

b- Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes. Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe.

c-Sasi pluhuri si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te gurit gëlqeror. Ky fenomen do te jete me i dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesojte kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle.

Ndotja ne toke. Persa i perket ndotjes se tokes ajo ne kete karriere mund te jete aksidentale nga derdhja e karburanteve qe perdorin makinat dhe mjetet e germimit. Ne karriere mjetet qe do te perdoren duhen te kontrollohen here pas here per rrjedhje te karburantetit dhe vajrave dhe te eliminohen ato. Toka e germuar si sterile do te grumbullohet ne sheshin e depozitimit te sterileve te caktuar ne harten e hapjes se karrieres me siperfaqe. Ne kete shesh duhet mbrojtur me kanale periferik te cilet bejne mbrojtjen nga erozionit te materjalit te germuar. Germimi i tokes nuk do te ndote ambjentin sepse nuk clirohet asnje lloj gazi.

Ndotja ne ujra. Ne vendburim nuk parashikojme te dalin ujra. Kurse ne siperfaqe ku do te zhvillohet aktiviteti mund te kete ndotje te derdhjeve pa dashje te vajrave dhe karburantet e automjeteve.

Ujrat e rreshjeve do të bëjnë shpëlarjen e sipërfaqes së objektit, duke marë me vete ato pjesë të materialit që mund ti lëvizin, po përsëri këto materiale janë pjesë e shkëmbinjve retues ose të gurit gëlqeror.

Ujrat e rreshjeve nëse nuk disiplinohen me kanale të kulimit, shkaktojnë erozion të sipërfaqes i cili vjen gjithnjë duke u agravuar, prandaj subjekti ka planifikuar që krahas hapjes së karrierës të bëjë dhe kanalet e disiplinimit të ujrave të rreshjeve.



Ç) Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme.

Industria minerare është shumë e rëndësishme në ekonominë e një vendi, por ajo shoqërohet edhe me ndikime mjedisore negative të cilat në disa raste mund të jenë të pashmangshme. Shume prej ndikimeve negative mjedisore mund të minimizohen përmes një planifikimi të kujdesshem mjedisor dhe aplikimit të teknikave dhe teknologjive së parandalimit të ndotjeve.

Ujrat e ndotur.

Në vendburim nuk parashikojmë të dalin ujëra dhe procesi teknologjik nuk parashikon përdorin e ujit, duke mënjuar krijimin e ujërave të ndotura. Nëse në sipërfaqe ku do të zhvillohet aktiviteti mund të ketë ndotje të derdhjeve pa dashje të vajrave dhe karburantet e automjeteve, atëherë do meren menjëherë masat e nevojshme për izolimin dhe pastrimin e mjedisit të ndotur. Përdorimi i ujit në këto objekt do të jetë vetë gjatë muajëve të verës për lagjen e territorit dhe minimizimin e sasive të pluhurit në atmosferë.

Gazet

Referuar natyrës së procesit nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosferë, Gazet prej mjeteve të punës janë në intervale kohore të shkurtra, brenda normave të lejuara pa ndonjë ndikim negativ në mjedisin përreth. Këto lloje mjeteve emetojnë sasi gazesh të cilat janë rezultat i punës së motorrave me djegie të brendshme, brenda normave të lejuara. Këto mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontrolleve teknike vecanërisht për emetimet e gazta.

Pluhuri

Operacionet e punës mund të gjenerojnë një sasi të konsiderueshme pluhuri çdo ditë, si rezultat i proceseve të prerjes të bllokut dhe automjeteve që udhëtojnë rreth zonës. Në varësi të përbërjes së gurit, mund të gjendet në grimcat e ajrit, duke buruar nga vetë guri. Për të lehtësuar ekspozimin ndaj grimcave të ajrit, rekomandohet përdorimi i procesit të lagësht për të zvogëluar pluhurin e ajrit. Në varësi të klimës, lagështimi i rrugës etj duhet të bëhet lagje e rrugëve të aksesit dhe ambienteve të punës me një botë uji që duhet të jetë gjithmonë prezent në kantier.

Zhurma

Zhurmat e mundshme nga teknologjia e përdorur. Burimet e zhurmave janë në sipërfaqe. Çdo burim përhap varet nga zhurma. Fusha akustike që rezultojnë varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimit të të gjitha pengesave ekzistuese, ndërmjet burimit dhe receptorit. Energjia zvogëlohet për gjatë rrugës si rezultat i absorbimit të sipërfaqeve, divergjencës gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Pajisjet e makinerit që do përdoren në këto aktivitet do plotësojnë direktivën 2000/14/CE të Parlamentit Evropian dhe të KE 8 maj 2000, do jenë të standartit të aplikueshëm në BE për zhurmat.



Prodhimi i mbetjeve

Shfrytezimi i ketije objekti nuk gjeneron mbetje te rrezikshme. Mbetjet strile qe gjenerohen nga shfrytezimi, jane pjesa vegjetale e kores se tokes ne nje trashesi mesatare 0.3m-0.5m dhe jane te pademeshme ne ambientin pererreth. Mbetje sterile qe dalin nga procesi i shfrytezimit te mineralit.

Për mbetjet urbane, nga punonjësit do të vendosen kosha për grumbullim dhe do të dërgohen në vendet e caktuara nga pushteti vendor.

D) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

Ndikimet negative të identifikuara me lart do te jene gjate gjithë kohes se zhvillimit te ketij aktiviteti. Ato mund te jene me te dukshme gjate stines se veres pasi edhe mundesia e shkarkimeve ne kete periudhe eshte me e madhe. Megjithate duhet theksuar se proceset e punes jane ne nje kohezgjatje jo te madhe dhe shkarkuimet ne mjedis jane minimale.

Nisur nga koh e lejes minerare, rezulton se

Dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Siperfaqja ku do te kryhen punimet per hapjen e rruges dhe punimet e shfrytezimit eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit, do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle sidomos do te mbajne larg zones disa lloje shtazore. Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe.

Sasia e gazeve NO₂ dhe SO₂ qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara do te jete e limituar ne kohe dhe nuk do te kete ndikime ne banoret e zones së Sheshi i Azines e më gjërë, qe janë fshatrat rreth objektit në distance mbi 1.5 km, por që përbëjnë qendra të banuara rreth objektit.

E) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Shoqeria ka hartuar nje **plan rehabilitimi progresiv të karrierës** që në vitin e parë, plan i cili do të zbatohet krahas shfrytëzimit dhe është në përputhje me *Formati Standart I Planit Te Rehabilitimit Te Mjedisit Per Vemprimtarine Minerare*, të nënshkruar nga dy ministra, I mjedisit dhe infrastrukturës.

Gjithashtu në këtë plan është trajtuar dhe rehabilitimi i sipërfaqes që zen impjanti i thyerje fraksionimit së bashku me vend depozitimet e materialit të fraksionuar.

Per rehabilitimin e tokes, do te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do te plotesohet me 30 cm dhe' (toke) te pasur me pleh. Gjate zbulimit të pjesës së mbetur, do te perfitohen dhe shtresa vegjetale e tokës të cilat do te veçohen nga masa tjetër e materialit të gërmuar dhe do të hidhet sa më pranë vendit ku do të fillojë rehabilitimi për të shmangur transportet e dyfishta brenda kantierit.



Përsa i takon stoqeve të zbulimit dhe mbetjeve minerare, nese do te nevojitet stabilizimi i ketij dheu nje pjese te faqes se pjerrret do te behet me trungje te ngulura ne toke me thellesi mbi 30 cm, dhe mulciritimi do te jete i thate dhe me kashte, gjrthe te bimeve te zones dhe dege. Mulciritimi do te sherbeje, si per uljen e humbjeve te farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe per uljen e aktivitetit erodikpersakohe vegjetacioni eshte i pazhvilluar mire.

Në proceset e rehabilitimit, konkretisht në mbjellje fidanesh, te kene renditjen me largesi fidanesh çdo 3-4 metra, gje qe do ti jape nje kurore dendesi mjaft te mire teritorit pas shfrytezimit, dhe lejon dritesimin per veterritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

Kombinimi i punimeve te shfrytezimit te gurores me ato te zbutjes se impakteve mjedisore si dhe punimet rehabilituese, do te kete si pasoje edhe rritjen e numrit te te punesuarve. Relievi i zones per te lejuar per shfrytezim eshte kodrinore dhe projekti për shfrytëzimin e saj fillon nga niveli më i lartë, me gjerësi dhe pjerrësi skarpate, sipas kushteve teknike te percaktuar Kjo garanton rehabilitimin e shkallës së sipërme të shfrytëzimit sapo të mbarojë.shfrytëzimi i kësaj shkalle duke zbritur nga lart-poshtë do te bëhet edhe rehabilitimi me shkallë.

Duke konsideruar sipërfaqet e shesheve që zene punimet e projektuara, në tabelen e meposhtme jepen shpenzimet e rehabilitimit:

Preventivi i rehabilitim per 1 ha per zonen e shfrytezuar dhe impant thyerje fraksionimi								
Nr.	Operacioni	Sip.	Normativa ha/ha	Sip. Operac. ha	Normativa m ³ /ha oper.	Volumi i punes (m ³)	Çmimi lek/njesi	Vlera
I	Plani i mbylljes se karieres							
a	Krehje sistemim I faqeve anesore	1	1,5	1,5	200	300	50	15000
	Shuma I	15000						
	SHUMA I	15000						
II	Plani I menaxhimit te mbetjeve							
a	Sistemim I mbetjeve te zbulimit	1	0,6	0,6	2000	1200	20	24000
b	Sistemim I mbetjeve teknologjike	1	0,25	0,25	2000	2000	20	40000
	SHUMA II	64000						
III	Plani I rehabilitimit perfundimtar te mjedisit							
		Sip.	Normativa ha/ha	Sip. Operac. ha	Normativa nr/ha	nr	Çmimi lek/njesi	Vlera
a	Mbushje me dhe' i sheshit fundor	1	0,5	0,5	2500	1250	35	43750
b	Mbjellje pemesh	1	0,5	0,5	300	150	100	15000
c	Hapje gropash	1	0,5	0,5	300	150	1000	150000



d	Blerje pemesh	1	0,5	0,5	300	150	50	7500
e	Sherbime	1	0,5	0,5	300	150	50	7500
f	Kanali i ujrave te larta, drenazhim		Normativa ml/ha		Gjatesia ml			Vlera
		1	300		300	75	200	15000
g	Sinjalistike							5000
i	Çmontim impianti		Nr. mesatar	Pesha (ton)	Nr. Punetor	Ore pune	Paga	Vlera
1	Çmontim I makinerive e paisjeve			15	3	48	341	16368
2	Çmontim impiantit te perpunimit		1	100	5	120	341	40920
3	Prishja e objekteve siperfaqsove		3	20	4	160	284	45440
SHUMA i1 - i3		102728						
j	Ngarkim materialesh		Sasia (ton)	Normativa ore/ton	Ore pune		Paga	Vlera
			135	1	135		341	46035
k	Transport materialesh, ngarkim, shkarkim		Sasia (ton)	Dist. Km	Çmimi l/ton/km			Vlera
			135	30	16			64800
SHUMA (III)		457300						
SHUMA (I+II+III)		536300						
Shpenzime suplementare		26815						
TOTALI		563115						

Bazuar ne **Urdherin 718 dt.03.10.2011 "Per Menyren e Vleresimit te Garancive financiare te lejeve Minerare"** japim perlllogaritjen per garancine financiare te rehabilitimit.

Subjekti për periudhën e kaluar ka paguar garancinë e rehabilitimit sipas urshërimit të mësipërm.

Siperfaqet e zones qe do te preken nga shfrytezimi jane si meposhte:

1-Siperfaqia qe preken nga rruge dhe transhet	= 2 662 m ²
2-Siperfaqet qe preken nga shesh depozitimi	= 4 789 m ²
3-Siperfaqia qe preket nga karriera	= 48 893 m ²
Siperfaqia totale qe preket nga shfryteimi	= 48 893 m ²

Shpenzimet per rehabilitimin e karrieres do te jene = 4.9 ha x 563 115 lek/ha = 2 759 263 lek
Vlera totale e garancise financiare per rehabilitimin e mjedisit do te jete: = 2 759 263 lek



Garancia vjetore per rehabilitimin do te jete :

2759263 / 14 vite = 197090 lekë/vit

Ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Masat per mbrojtjen e tokes

Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
Shqetesim i shtreses se tokes per shkak te ndertimit te rruges se re lidhese	Sasia e dheut mund te sistemohet pergjate rruges dhe te perdoret per qellime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytezimit ose per rehabilitimin e rrugeve dhe siperfaqeve te demtuara ne perfundim te shfrytezimit te minieres.
Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit si kamione etj.	Per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes do te shfrytezohen vendet e caktuara
Erozion siperfaqesor ne mot me reshje	Do te vazhdojë piketomi dhe hapen kanalet e drenazhimit ne siperfaqe. Pergjate segmenteve rrugore ne varesi te terrenit dhe kushteve te tokes do vazhdojë hapja e kanale anesore qe do te ndalim forcen gerryese te ujrave te reshjeve, ndersa pergjate perimetrin te sheshit te depozitimit te mineralit do te hapen kanale perimetrike kufizuese qe do te frenojne gerryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjerresise nga ujrat siperfaqesore. Ne pjese te veçanta do te shihet mundesia e mbjelljeve te fidaneve pyjore te pershtatshem per zonen fitoklimatike.
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Makinerite e shfrytezimit dhe transportit do te kontrollohen per gjendjen e tyre teknike dhe nese konstatohen pjese te amortizuara qe mund te rrjedhin lubrifikante do te zevendesohen me te reja. Ne rast te ndonje aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale te lendeve ndotese ne mjedis do te merren masa per pastrimin e menjehershem te tokes se ndotur e cila do te depozitohet ne nje kazan te posatshem metalik ose prej betoni per t'u djegur me pas
Masat per mbrojtjen e ajrit	
Lloji i ndikimit	Masat e propozuara



Emetime te pluhurit, zhurmes, gazeve, aromave dhe vibracione

Manikerite duhet te mirembahen teknikisht qe zhurma e tyre te jete vetem ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet te perdoren me eficence dhe te minimizohet koha gjate se ciles mbahen ndezur motoret. Skapamentot duhet te kene ne gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike te kapjes se grimcave (skapamentot e makinerive kane nje jastek te posatshem per kete gje). Do te perdoret nafta me permbajtje te ulet sqfuri. Transporti i materialeve te behet me mjete te pastra nga balta dhe te mbuluara nese rruget kalojne prane ose neper qendrat e banuara. Te menjahet renia e borive te automjeteve nga shoferet per te mos krijuar zhurme dhe stress tek banoret. Qarkullimi i kamioneve ne qendrat e banuara te behet me shpejtesi te ulet gje qe shmang jo vetem aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.

Masat per mbrojtjen e pejsazhit

Lloji i ndikimit

Masat e propozuara

Ndikime ne pejsazh dhe topografine e relievit

Gjate shfrytezimit nuk duhet te demtohen siperfaqe te panevojshme si pasoje e mosplanifikimit te sakte apo e neglizhences se punetoreve qe mund te presin peme apo te shkaktojne zjarre dhe demtojne pejsazhin dhe bimesine e zones

Masat per mbrojtjen e biodiversitetit

Lloji i ndikimit

Masat e propozuara

Ndikime ne faune

Shoferet jane udhezuar dhe do te udhezohen te bejne kujdes gjate transportit ne zona pyjore per te mos shtypur kafshe qe mund te jene ne mes te rruges. Shoferet duhet te spostojne kafshet pastaj te vijojne udhetimin

Masat per administrimin e mbetjeve urbane

Lloji i ndikimit

Masat e propozuara



Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njezozor

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetesor i punetoreve apo ambalazhet do te grumbullohen neper thase te posaçem dhe do te transportohen drejt qendrave me te aferta te banuara per menaxhim nga sektoret perkates te pushtetit lokal. Gomat dhe vaji lubrifikant te perdoruar do t'u jepen subjekteve qe merren me riciklimin e tyre dhe qe aktualisht operojne edhe ne Shqiperi (Ministria e Mjedisit posedon nje liste te subjekteve riciklues)

F) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk sjell ndikimet te mundshme në mjedisin ndërkufitar, për shka se objekti ndodhet shumë larg kufirit ndërshtetror, si dhe ndikimi i aktivitetit minerar nuk kalon kufijtë e lejes minerare.

Subjekti do te kujdeset per administrimin e çdo informacioni qe lidhet me ushtrimin e veprimtarise. Administrimi i te dhenave konsiderohet shume i rendesishem per menyren e operimit te subjektit dhe do te perdoret per te permiresuar eficencen e çdo mase te parashikuar per zbutjen e ndikimeve ne mjedis dhe ne teresi. Per mbajtjen e te dhenave do te perpilohet nje regjister i veçante, fushat e te cilit te mbulojne te gjithë llojin e informacionit te mbledhur qe lidhet me aktivitetin e minieres.

HARTOI : INNOVATION DEVELOPMENT ENGINEERING .SH.K.K.

**EKSPERT MJEDISOR :
EKSPERT MJEDISOR :
GJEOINXHINIER :
GJEOINXHINIER :**

**BARDHYL SHUSHKU
XHEVAHIR DERMISHI
ERMIR DERMISHI
DENIS STASA**

